



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:006131

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05761642

P.nr.14/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Valon Hajdini, procesmbajtësin – praktikant H.K., në çështjen penale ndaj të pandehurit D.M., i akuzuar për veprën penale: Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore nga neni 260 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.3337/19, të datës 28.01.2021. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor në prezencën e palëve, prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Muharrem Prekazi, i pandehuri D.M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 21.05.2024, pas administrimit të provave materiale, i akuzuari D.M. ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, gjykata ka shpallur publikisht aktgjykimin më datë 22.05.2024, ndërsa më dt.31.05.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

D.M., nga i ati R., nëna Xh., e gjinisë D., i lindur më datë..., në fshatin..., Komuna Skenderaj, me vendbanim në rrugën... në Skenderaj, me numër personal..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin e pedagogjisë, i martuar baba i tre fëmijve, pronar i barnatores... BI, i gjendjes së mesme ekonomike.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Ekziston dyshimi i bazuar mirë që nga data e pacaktuar deri më datë 23.09.2019 në Skenderaj në rrugën..., saktësisht në barnatoren... që është pronë e të D.M., mbi bazën e kontrollit të inspektorëve farmaceutik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, kanë hasur dhe konfiskuar një sasi

të prodhimeve farmaceutike (barna) me skadim të datës së prodhimit dhe pa banderola, përkatësisht në sasi prej 120 pako të llojeve të ndryshme, 28 copë ampula të cilat janë të ndaluara në territorin e Kosovës, në kundërshtim me nenin 40 par. 6 të Ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale dhe në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të udhëzimit administrativ nr.11/2015 për Qarkullues Farmaceutik me pakicë, të cilat barna janë konfiskuar nga Inspektorët Farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë.

Me këtë ka kryer veprën penale Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore nga neni 260 par.2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

- Andaj, gjykata në bazë të neneve : 1, 2, 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 72 të KPRK-së, e lidhur me nenin 364, 449 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, të pandehurit i D.M. i:

SH Q I P T O N

I.DËNIM ME GJOBË në shumën prej 2500€ (dymijë e pesëqind) euro, të cilin dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i'u përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë

II. Në dënimin e shqiptuar me gjobë në mbështetje të nenit 79 par.2 të KPRK-së i llogaritet edhe gjoba administrative e shqiptuar në shumën prej 1000€ (njëmijë) euro nga Inspektorati Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë, sipas vendimit Nr. 10/RM-008-19 të datës 07.10.2019, e cila është paguar nga i pandehuri sipas faturës nr.0001008.

III.Në mbështetje të nenit 260 par.8 të KPRK, lidhur me nenin 276 par.1 e lidhur me par.2 pika 2.3 të KPP-së,

Gjykata nxjerrë këtë URDHËR:

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve në vijim, 120 pako me barëra të ndryshme dhe 28 copë ampula me afat të skaduar dhe pa banderola të sekuestruara në barnatoren "ANA" B.I., në Skenderaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjtat të shkatërrohen nga Inspektorati Farmaceutik nga Ministria e shëndetësisë e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

IV. I pandehuri D.M. obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumë prej 20 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 40 (katër dhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3337/19, të datës 12.01.2021 pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega Skenderaj- Departamenti i përgjithshëm, ndaj të pandehurit D.M. për shkak të veprës penale: Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore nga neni 260 par.2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.05.2024, prokurori i shtetit ka korrigjuar dispozitivin e aktzakuzës sa i përket përshkrimit të gjendjes faktike, po ashtu ka propozuar konfiskimin e përhershëm të barnave dhe shkatërrimin e tyre.

Rrjedha e procedurës penale:

Më datë 21.05.2024 Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor e cila ka qenë e hapur për publikun. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Muharrem Prekazi, dhe të pandehurit D.M..

Pas administrimit të provave materiale i pandehuri D.M., ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore nga neni 260 par.2 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit D.M. në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka marrë mendimin e prokurorit të shtetit, i ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është njoftuar nga ana e gjykatës për të metat dhe benifitet e pranimin të fajësisë, i njëjti gjen mbështetje në provat dhe faktet e kësaj çështje penale, i pandehuri pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion apo ndërhyrje dhe pasi që i ka kuptuar pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë i ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë.

Gjykata në mbështetje të nenit 322 par.1 të KPRK-së ka bërë pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit D.M. pasi që i njëjti gjenë mbështetje në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor: Vendimi i inspektoratit farmaceutik për shqiptimin e dënimit me gjobë nr.10RM-008-19 i datës 07.10.2019, Fatura me numër serik 0001208 në emër të D.M. për pagesën e dënimit me gjobë, Raporti nga inspektorati farmaceutik i datës 07.10.2019 REF.NO.10/RM024-19, Procesverbali mbi inspektimin e kryer nr.00922 nga inspektorati farmaceutik i datës 23.09.2019, Procesverbali mbi inspektimin e kryer nr.00923 nga inspektorati farmaceutik i datës 23.09.2019, fleta përmbledhëse e produkteve dhe pajisjeve medicinale të konfiskuara nr.000660, e datës 23.09.2019, fleta përmbledhëse e produkteve dhe paisjeve medicinale të konfiskuara nr.000661, e datës 23.09.2019, fleta përmbledhëse e produkteve dhe paisjeve medicinale të konfiskuara nr.000662, e datës 23.09.2019, fleta përmbledhëse e produkteve dhe paisjeve medicinale të konfiskuara nr.000663, e datës 23.09.2019, Kopja e planit të barnatores... nga kompania projektuese N... pro..., fotot nga vendi i ngjarjes të barnatores... gjithsejt 5 fotografi në 5 fleta të formatit A4, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin dhënë në polici i datës 25.09.2019, nr.2019-KE-402, dokumenti mbi biznesin e regjistruar nga ARBK në emër të D.M., B.I. Procesverbali i marrjes në pyetje i datës 12.01.2021 dhënë në prokurori nga i pandehuri D.M.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri D.M. është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

-Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar pasi që i pandehuri D.M. ka pranuar fajësinë kërkoj që si rrethana rënduese të merr shkallën e lartë të dashjes, rrezikun shoqëror që paraqet kjo vepër, kurse si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre rrethanave dhe atyre të cilat do ti gjejë gjykata i propozoj gjykatës të pandehurit ti shqiptoj një dënim adekuat dhe ligjor me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

I Pandehuri D.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më vjen keq për rastin që ka ndodhur, i kërkoj falje gjykatës, dhe i premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të cilat bien ndesh me ligjin, gjithashtu i kërkoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim më të butë, pasi që jam baba i tri vajzave të mitura, jam mbajtës i familjes, dhe një dënim i shqiptuar me burgim do të ndikonte në rrezikshmërinë dhe ekzistencën që lidhet me gjendjen ekonomike të familjes time.

-Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin D.M., ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën, pendimin e sinqertë, kërkim faljen palës së dëmtuar, i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar që lë të kuptohet se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes, nga të hyrat e të cilit varen e ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale për të cilat akuzohet, kurse si rrethana rënduese gjykata ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, motivin e kryerjes së veprës penale, e që është përfitimi i dobisë pasurore përmes shantazhit, intensiteti i rrezikimit dhe vlerës së mbrojtur e që është rrezikimi i jetës së njerëzve duke shitur barëra pa banderola dhe pa afat.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit D.M. në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprave penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

-Konfiskimi:

Në mbështetje të nenit 260 par.8 të KPRK, lidhur me nenin 276 par.1 e lidhur me par.2 pika 2.3 të KPP-së, gjykata ka bërë konfiskimin e përhershëm të barnave të sekuestruara pasi prokurori i

shtetit ka propozuar konfiskimin e tyre, e po ashtu edhe ligji e përcakton konfiskimin e detyrueshëm të tyre. produktet mjekësore barërat e sekuestruara nga inspektorati farmaceutik të bëhet konfiskimi i përhershëm i tyre dhe të urdhërohet inspektorati farmaceutik në bashkërendim me Policinë e Kosovës të bëjë shkatërrimin e tyre, pasi që një konfiskim të tillë e përcaktojnë dispozitat e lartëcekura.

-Shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në shumën prej (20) njëzet euro dhe (20) njëzet në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në total prej (40) katërdhjetë euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 dhe 369 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.14/2021 të datës 31.05.2024.

Procesmbajtësi

H.K.

Gjyqtari i vetëm gjykues

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.